



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo**  
**Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution**

---

## AVOKATI I POPULLIT

i drejtohet

Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

me

### KËRKESE

*për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të nenit 9 (paragrafët 5 dhe 7), nenit 14, nenit 16, nenit 26, nenit 79, paragrafi 4, nenit 89, paragrafi 12, të Ligjit nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore*

### PALËT PËRGJEGJËSE

Kuvendi i Republikës së Kosovës

Prishtinë, më 25 korrik 2024

## **PËRMBAJTJA**

<b>I. PYETJET E PARASHTRUARA.....</b>	<b>3</b>
<b>II. JURIDIKSIONI.....</b>	<b>4</b>
<b>III. SFONDI LIGJOR.....</b>	<b>4</b>
<b>IV. ARGUMENTI.....</b>	<b>5</b>
<b>V. KËRKESË PËR MASË TË PËRKOHSHME.....</b>	<b>15</b>
<b>VI. PËRFUNDIMI.....</b>	<b>16</b>

## I. PYETJET E PARASHTRUARA

Ligji nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore rregullon procedurat për administrimin e detyrimeve tatimore në Republikën e Kosovës, që janë në fushëveprimin e Administratës Tatimore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji i kontestuar), si dhe parimet e organizimit dhe të funksionimit të Administratës Tatimore të Kosovës (më tej: ATK).

Çështjet të cilat Avokati i Popullit ngre para Gjykatës Kushtetuese, e të cilat kanë të bëjnë me kushtetutshmërinë e ligjit të kontestuar, janë si në vijim:

- Nëse neni 14 [vetëvlerësimi], neni 16 [Kufizimet kohore për vlerësimet] dhe neni 26 [Kreditimet dhe rimbursimet] janë në përputhshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.
- Nëse neni 9 [Mbledhja e informatave ose provave] paragrafët 5, 6 dhe 7, është në përputhje me nenin 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës.
- Nëse neni 79, paragrafi 4, i Ligjit të kontestuar ka marrë parasysh gjetjet e Gjykatës Kushtetuese të shprehura nëpërmjet Aktgjykimit në rastet nr. KO 216/22 dhe KO 220/22, për sa u përket emërimit dhe mandatit të pozitave drejtuese në Administratën Tatimore të Kosovës, si dhe nëse është në përputhshmëri me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës].
- Nëse neni 89, paragrafi 12, i Ligjit të kontestuar është në përputhshmëri me nenin 32 [Mjetet Juridike], me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe me nenin 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës.

## II. JURIDIKSIONI

Përmes kësaj kërkesë, Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës kërkon vlerësimin e përrputhshmërisë me Kushtetutën të nenit 9 (paragrafët 5 dhe 7), nenit 14, nenit 16, nenit 26 (paragrafi 1), nenit 79 (paragrafi 4), nenit 89 (paragrafët 1, 7, 8 9,10, 11 dhe 12), nenit 91 të Ligjit të kontestuar.

Kërkesa e Avokatit të Popullit për vlerësimin e neneve të kontestuara është brenda juridiksionit lëndor të Gjykatës Kushtetuese.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) përcakton: “Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute.” (po aty, neni 135, par. 4); dhe në veçanti, Avokati i Popullit është “i autorizuar të ngre [...] çështjen e përrputhshmërisë së ligjeve [...] me Kushtetutën.” (po aty, neni 113, par. 2, nënpar. 1).

Kërkesa e Avokatit të Popullit parashtrohet gjithashtu brenda juridiksionit kohor të kësaj gjykate: “Kërkesa e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 2 të Kushtetutës do të parashtrohet [...] nga ana e Avokatit të Popullit [...] brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.” (Ligji për Gjykatën Kushtetuese, neni 29, par. 1, dhe neni 30). Ligji i kontestuar ka hyrë në fuqi më 27 janar 2024, 15 ditë pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës (shih Ligjin e kontestuar, nenin 123). Prandaj, kërkesa e Avokatit të Popullit parashtrohet brenda afatit gjashtëmuor, i cili është përcaktuar nga Ligji për Gjykatën Kushtetuese.

## III. SFONDI LIGJOR

### Kushtetuta e Republikës së Kosovës

#### Neni 24 [Barazia para Ligjit]

“1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.”

#### Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]

“1. Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”

#### Neni 36 [E Drejta e Privatësisë]

“1. Çdokush gëzon të drejtën që t'i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera.

2. Kontrolllet e cilësdo banese ose cilitdo objekti privat, që mendohet se janë të domosdoshme për hetimin e krimit, mund të bëhen vetëm deri në shkallën e domosdoshme dhe vetëm pas

miratimit nga ana e gjykatës, pas shpjegimit të arsyeve pse një kontroll i tillë është i domosdoshëm. Shmangia nga kjo rregull lejohet, nëse është e domosdoshme për arrestim të ligjshëm, për mbledhjen e provave që ka rrezik të humbasin ose për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për njerëzit dhe për pasuri, në mënyrën e përcaktuar me ligj. Gjykata duhet që të miratoj veprimet e tilla në mënyrë retroaktive.

3. Fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimit tjetër, është e drejtë e pacenueshme. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm përkohësisht, në bazë të vendimit gjyqësor, nëse është e domosdoshme për ecurinë e procedurës penale ose për mbrojtjen e vendit, në mënyrën e parashikuar me ligj.

4. Secili person gëzon të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale. Mbledhja, ruajtja, qasja, korrigjimi dhe shfrytëzimi i tyre rregullohet me ligj.”

#### **Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]**

“1. E drejta e pronës është e garantuar.

2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.”

#### **Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]**

“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”

#### **Neni 101 [Shërbimi Civil]**

“1. Përbërja e shërbimit civil do të pasqyrojë shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës, duke marrë në konsideratë parimet e barazisë gjinore, të njohura ndërkombëtarisht.

2. Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës.”

#### **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

##### **Neni 8 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare]**

“1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”

#### **IV. ARGUMENTI**

1. Avokati i Popullit ka vërejtur se Ligji nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore ka hyrë në fuqi më 27 janar 2024.
2. Më 12 mars 2024, Avokati i Popullit ka pranuar ankesë nga disa zyrtarë të ATK-së, të cilët kanë shfaqur pakënaqësinë e tyre karshi përcaktimeve në Ligjin e kontestuar, përkatësisht kanë pretenduar se me nenin 79, paragrafi 4, atyre po u cenohet e drejta e

pronës, e garantuar me Kushtetutë. Po ashtu, ankuesit kanë pretenduar se përcaktimet në nenin 89 dhe në nenin 91 ua cenojnë atyre të drejtat e garantuara me Kushtetutë. Lidhur me këtë çështje, ankuesit kanë kërkuar nga Avokati i Popullit që ta referojë Ligjin e kontestuar për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese.

3. Lidhur me këtë çështje, më 21 maj 2024, Avokati i Popullit ka organizuar tryezë dhe ka ftuar subjekte përfaqësues të komunitetit të bizneseve në Republikën e Kosovës, të cilët kanë paraqitur dilemat e tyre lidhur me disa dispozita të Ligjit të kontestuar.
4. Në këtë drejtim, në takim janë ngritur dilema rreth përmbajtjes së neneve 6, 9, 16 dhe 26, si dhe është diskutuar nëse nenet e theksuara janë në pajtim me Kushtetutën.
5. Avokati i Popullit konsideron se Ligji i kontestuar në përgjithësi konsiderohet progresiv, sepse e ka ngritur standardin normues në disa çështje, megjithatë Avokati i Popullit e konsideron të nevojshme që për disa çështje t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për vlerësim nëse nenet e theksuara më sipër janë në pajtim me Kushtetutën.

### **Për sa i përket barazisë para ligjit, sipas nenit 24 të Kushtetutës**

6. Avokati i Popullit ka analizuar Ligjin e kontestuar dhe ka vërejtur:

- Neni 14 [Vetëvlerësimi] i Ligjit të kontestuar përcakton:

*“1. Aty ku një person dorëzon një deklaratë tatimore të kërkuar sipas legjislacionit në fuqi, tatimi i deklaruar si detyrim, nëse ka të tillë, në deklaratën tatimore trajtohet si vetëvlerësim i tatimpaguesit për detyrimin tatimor të pagueshëm dhe të saktë.*

*2. Tatimpaguesi mund të dorëzojë një ndryshim të deklaratës tatimore, brenda tre (3) viteve pas datës obligative kur deklarata është kërkuar të dorëzohet fillimisht, nëse më vonë zbulon gabim në deklaratën tatimore të cilën e ka dorëzuar paraprakisht.*

*3. Kur tatimpaguesi kupton para kalimit të periudhës së vlerësimit, se një deklaratë e dërguar nga ai ose për atë është e pasaktë apo e pakompletuar dhe kjo mund të shpie apo vetëm e ka shpie në nën-deklarim të tatimit apo mbi-deklarim të rimbursimit të tatimeve dhe kredive, ai është i obliguar të deklarojë këtë pa vonesë dhe të bëjë korrigjimet e nevojshme.*

*4. Obligimi i përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni është i vlefshëm edhe mbi titullarin e ardhshëm të tatimpaguesit apo tatimpaguesin në bazë të nenit 12 të këtij Ligji. Obligimi për njoftim aplikohet kur kushtet për lirim nga tatimet, zvogëlimet tatimore apo privilegjet tjera tatimore pushojnë së ekzistuari, qoftë plotësisht apo pjesërisht. [...]*

- Neni 16 [Kufizimet kohore për vlerësimet]

*1. Administrata Tatimore e Kosovës mund të bëjë vlerësimin në çdo kohë, për rastet kur:*

*1.1. një person nuk ka dorëzuar deklaratën tatimore;*

*1.2. një person, me synim të shmangies së tatimeve, ka dorëzuar një formular tatimor;*

*1.3. sjellja mashtruese e një personi të tretë ka çuar në nën raportimin e tatimit apo mbi raportimin e kreditimeve.*

*2. Në zbatim të paragrafit 1 të këtij neni, të gjitha tatimet vlerësohen brenda gjashtë (6) viteve nga data kur deklarata tatimore me të cilën lidhet vlerësimi ka qenë obligues, apo datën kur është paraqitur deklarata, cilado qoftë më e vona.*

• *Neni 26 [Kreditimet dhe rimbursimet]*

1. *Çdo shumë e tatimit e paguar mbi shumën e detyrimit tatimor, kreditohet ndaj detyrimit aktual të tatimpaguesit për çdo detyrim tjetër tatimor dhe kontribute. ATK i dorëzon tatimpaguesit njoftim me shkrim aty ku pagesa e tepërt është përdorur për mbulimin e një detyrimi tjetër, duke e informuar tatimpaguesin për shumën e kreditimit të aplikuar, tatimin dhe periudhën tatimore.*
2. *Në rastin kur tatimpaguesi nuk ka detyrime tjera ndaj ATK, ose kur ka mbetur një shumë teprice nga tatimi i mbi paguar, pasi teprica e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni është përdorur për të shlyer detyrimet e tjera tatimore, tatimpaguesi mund t'i kërkojë ATK rimbursimin e shumës së mbetur.*
3. *Kërkesa për kreditim ose rimbursim për një pagesë të tepërt të çfarëdo lloji të tatimit mund të dorëzohet brenda tre (3) vitesh nga data kur është paguar tatimi apo kur ka lindur e drejta e zbritjes.*
4. *Administrata Tatimore e Kosovës shqyrton kërkesën për rimbursim brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike nga data kur ka pranuar kërkesën nga tatimpaguesi, duke siguruar që detajet e shumës për rimbursim i janë përcjellë me kohë Ministrisë ose me rastin e kontributeve në FKPK apo në fondet tjera përkatëse.*
5. *Në rastin kur tatimpaguesi ka të drejtë për rimbursim sipas paragrafit 2 të këtij neni dhe ky rimbursim nuk është zbatuar brenda afatit të paraparë në paragrafin 4 të këtij neni, ATK i paguan tatimpaguesit, përveç shumës së përcaktuar nga ATK për rimbursim edhe interesin në shkallën e përcaktuar nga Ministri. Kur ATK vendos se nuk duhet të lëshohet një rimbursim, apo duhet të mbahet për arsye administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi, interesi nuk do të jetë obligim në shumën që nuk është lëshuar apo është mbajtur.*
6. *Interesi sipas paragrafit 5 të këtij neni, fillon të rrjedh nga dita e tridhjetenjë (31) nga data e parashtrimit të kërkesës për rimbursim. Ky interes, llogaritet në bazë mujore, për çdo muaj apo pjesë të muajit, deri në pagesën e rimbursimit.[...].”*
7. *Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit thekson se periudha kohore kur tatimpaguesi mund të kthehet prapa për korrigjimin e një vetëdeklarimi dhe të paraqesë një kërkesë për rimbursim/kreditim, me Ligjin e kontestuar është shkurtuar në 3 vjet, ndërsa me ligjin paraprak kjo periudhë ishte 6 vjet. Pra, tatimpaguesi mund të korrigjojë një deklaratë që ka dorëzuar vetë vetëm për 3 vjet prapa nga data kur është e obligueshme për deklaratën tatimore (Neni 14) si dhe mund të kërkojë rimbursim/kreditim për 3 vite prapa nga data kur është paguar tatimi (Neni 26).*
8. *Në anën tjetër, sipas nenit 16 të Ligjit të kontestuar, Avokati i Popullit ka vërejtur se ATK-së nuk i është ndryshuar afati kohor, brenda të cilit ka të drejtë të bëjë vlerësim tatimor. Në këtë rast Avokati i Popullit ka vërejtur se edhe me ligjin paraprak, por edhe me Ligjin e kontestuar, afati kohor që ATK-ja të mundë të bëjë vlerësimin tatimor është 6 vjet.*
9. *Në këtë drejtim, Avokati i Popullit konsideron se shkurtimi i afatit karshi bizneseve tatimpaguese, ndërsa lënia e afatit të njëjtë për ATK-në, i vendos në pozicion të pabarabartë bizneset përballë ATK-së, e njëkohësisht i vendos në pozicion të pafavorshëm.*

10. Lidhur me pozicionin e pafavorshëm të bizneseve tatimpaguese, Avokati i Popullit konsideron se shkurtimi i afatit do t'ua pakësojë atyre kohën brenda së cilës mund të korrigjojnë veprimet e tyre dhe njëkohësisht do t'ua vështirësojë atyre mundësinë e korrigjimit të gabimeve, për të cilat Ligji i kontestuar e ka lënë mundësinë e korrigjimit.

11. Përkitazi me këtë çështje, Avokati i Popullit ka analizuar edhe Ligjin nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe ka vërejtur se në nenin 2 [Fushëveprimi] përcaktohet:

*“Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me:*

[...]

*1.16. çfarëdo të drejte tjetër të paraparë me legjislacionin në fuqi.”*

12. Avokati i Popullit thekson se qëllimi i Ligjit Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit me bazat e mbrojtura me nenin 1, si dhe nga koncepti i diskriminimit i përcaktuar në po këtë ligj (neni 3), diskriminimi karakterizohet nga shkelja e parimit të trajtimit të pabarabartë (neni 4, paragrafi 2). Pra, për t'u konsideruar se në një rast ka diskriminim, duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “bazën e mbrojtur”, dhe se ky trajtim realizohet me veprim apo mosveprim, në raport me personin tjetër në një situatë të krahasueshme sipas një apo më shumë bazave të mbrojtura ligjore.

13. Avokati i Popullit, duke iu referuar praktikës së GjEDNj-së, ka vërejtur se në rastin *Dakir kundër Belgjikës*, § 65. GjEDNj-ja rithekson se një politikë ose masë e përgjithshme që ka efekte paragjyquese joproportionale ndaj një grupi individësh mund të konsiderohet si diskriminuese edhe nëse nuk e synon në mënyrë specifike grupin dhe nuk ka qëllim diskriminues. Megjithatë ky është vetëm rasti nëse një politikë ose masë e tillë nuk ka justifikim “objektiv dhe të arsyeshëm”, domethënë nëse nuk ndjek një “qëllim legjitim” ose nëse nuk ka një “marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti” ndërmjet mjeteve që përdoren dhe synimit që kërkohet të arrihet (shih po ashtu *S.A.S. kundër Francës*, § 161).

#### **Për sa i përket së drejtës për mjete juridike, sipas nenit 32 të Kushtetutës**

14. Avokati i Popullit ka vërejtur se neni 89 [Shqyrtimi i përgjegjësive disiplinore dhe mbrojtja e të drejtave nga marrëdhënia e punës], paragrafi 12, i Ligjit të kontestuar përcakton: *“Punonjësi i cili nuk është i kënaqur me vendimin e Komisionit të Ankesa apo mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, mund të iniciojë procedurën në gjykatën kompetente.”*

15. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit ka analizuar Ligjin nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë dhe ka vërejtur se në nenin 6 [Nëpunësja/i civil me status të veçantë], paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, si dhe nenin 27 [E drejta për informim për marrëdhënien e punës dhe e drejta e ankesës], paragrafët 3 dhe 5, përcaktohet:

- *“Neni 6 Nëpunësja/i civil me status të veçantë*



1. Nëpunësja/i civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunëses/it civil, ku bëjnë pjesë:

[...]

1.7. të punësuarat/it në Administratën Tatimore të Kosovës;

- Neni 27 [E drejta për informim për marrëdhënien e punës dhe e drejta e ankesës]

[...]

3. Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil.

5. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHCK sipas paragrafit 3. dhe 4. të këtij neni, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.”

16. Për më tepër, Avokati i Popullit ka analizuar Ligjin nr.06/L - 048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe ka vërejtur se në nenin 2 [Fushëveprimi] përcaktohet: “Fushëveprimi i këtij ligji përfshinë Këshillin dhe të gjitha institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil.”

17. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh konstatimet e Gjykatës Kushtetuese, të shprehura në Aktgjykimin KO 216/22 dhe KO 220/22, ka vërejtur se Gjykata ka konstatuar: “Në këtë kontekst, sipas praktikës së GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, për të përjashtuar të drejtën në mjet juridik, (i) duhet të argumentohet se ligji vendor përjashton në tërësi të drejtën për mjet juridik në llojin e caktuar të kontesteve; dhe për më tepër (ii) përjashtimi i tillë mbështetet në arsye objektive të interesit shtetëror (shih, rastin e Gjykatës KO100/22 dhe KO101/22, cituar më lart, paragrafi 381, dhe rastin e GJEDNJ-së, Grzëda kundër Polonisë, nr. 43572/18, Aktgjykim i 15 marsit 2022, paragrafi 290).” (Paragrafi 392).

18. Avokati i Popullit konsideron se në rastin e Ligjit të kontestuar është përjashtuar krejtësisht mundësia e inicimit të procedurave në KPMSHCK, nga punonjësit e ATK-së.

19. Duke pasur parasysh përcaktimet e mësipërme të Ligjit për Zyrtarët Publikë (nenet 6 dhe 27) dhe të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (neni 2), Avokati i Popullit konsideron se përderisa punonjësit e ATK-së bëjnë pjesë në kategorinë e nëpunësve civilë me status të veçantë, ata u binden rregullave të përgjithshme për shërbimin civil.

20. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit thekson se paragrafi 12 i nenit 89 të Ligjit të kontestuar, i cili i udhëzon palët e pakënaqura me vendimin e komisionit të ankesave që t'i drejtohen gjykatës kompetente, ua mohon punonjësve të ATK-së të drejtën për mjete juridike, përkatësisht shfrytëzimin e mjeteve juridike për inicimin e procedurës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

21. Sipas këtij përcaktimi, Avokati i Popullit konsideron se punonjësit e ATK-së trajtohen ndryshe nga punonjësit e institucioneve të tjera, pa pasur ndonjë arsye të dukshme apo një qëllim legjitim të dukshëm, e që rrjedhimisht përcaktime të tilla bien ndesh edhe me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës. Megjithatë në këtë rast Avokati i Popullit është fokusuar vetëm te neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] i Kushtetutës.

22. Prandaj, marrë parasysh këtë që u theksua më sipër, Avokati i Popullit e konsideron të rëndësishme që Gjykata Kushtetuese të vlerësojë nëse neni 89, paragrafi 12, i Ligjit të kontestuar është në pajtim me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], me nenin 45 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe me nenin 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës.

**Për sa i përket së drejtës së privatësisë, sipas nenit 36 të Kushtetutës**

23. Avokati i Popullit ka vërejtur se Ligji i kontestuar:

- Neni 9 [Mbledhja e informatave ose provave], paragrafët 5, 6 dhe 7, përcakton:

“5. Për qëllime të mbikëqyrjes së fakteve që janë relevante me tatime, institucionet financiare duhet të dorëzojnë në ATK informatat për të gjitha **transaksionet** vendore dhe ndërkombëtare, në valutën vendore dhe të huaj, të llogarive të personave juridik, personave fizikë afarist dhe jo-afarist, përfshirë këtu edhe depozitat e kursimeve.

6. Për qëllime të mbikëqyrjes së fakteve që janë relevante me tatime, Noterët duhet të dorëzojnë në ATK informatat për të gjitha kontratat e shitblerjeve nga personat juridik, personat fizikë afarist dhe personat fizikë jo-afarist.

7. Informatat sipas paragrafit 5 dhe 6 të këtij neni do të dorëzohen nga bankat dhe Noterët përmes teknologjisë informative në dispozicion, në baza mujore, tremujore ose sipas kërkesës.”

- Neni 15 [Vlerësimi i ATK për tatimin] i Ligjit të kontestuar përcakton:

“1. Aty ku ATK beson në bazë të dëshmive se informatat e siguruara nga një person në deklaratën tatimore nuk paraqesin në mënyrë të saktë detyrimin e tij tatimor, ose kur tatimpaguesi nuk ka dorëzuar deklaratën e kërkuar me këtë Ligj, ATK mund të bëjë një vlerësim të detyrimit të tij tatimor, përfshirë, por duke mos u kufizuar në vlerësimet që rezultojnë nga përdorimi i dokumentacionit apo transaksioneve fiktive.

2. Përveç rasteve që paraqesin vepra penale në fushën e tatimeve apo kur shuma e obligimit tatimor mund të përcaktohet me saktësi, vlerësimet sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhen pas fillimit të procedurave të kontrollit siç janë përcaktuar në nenin 8 të këtij ligji, nëse procedurat e tilla kërkojnë. Kufizimi i vënë me këtë paragraf nuk zbatohet në dispozitat e nenit 17 të këtij ligji.

3. Vlerësimi i ATK bëhet sipas gjykimit të saj më të mirë dhe bazohet në të gjitha provat të cilat i ka në dispozicion, përfshirë:

3.1. librat, regjistrat, kuponët, faturat, si dhe informatat tjera përkatëse të tatimpaguesit;

3.2. librat, regjistrat, kuponët, faturat, si dhe informatat tjera përkatëse të personave të tretë; 3.3. informatat nga personat të cilët mund të verifikojnë saktësinë e deklaratave, librave dhe regjistrave të tatimpaguesit;

3.4. informatat e tjera objektive rreth të ardhurave dhe/ose transaksioneve të tatimpaguesit, lidhur me detyrimin e tij;

3.5. informatat e siguruara gjatë vizitave tek tatimpaguesit sikurse është paraparë në paragrafin 1 të nenit 8 të këtij ligji; dhe

3.6. zbatimin e këtij ligji dhe/ose ligjeve tatimore në fuqi.

4. Në qoftë se librat dhe regjistrat e tatimpaguesit kanë humbur apo janë shkatërruar, ose ekzistojnë rrethana tjera që bëjnë të pamundur përcaktimin e detyrimit tatimor, ATK bën një vlerësim të parashikuar, i cili bazohet në mjetet, të ardhurat qarkulluese, shpenzimet e prodhimit, shpenzimet krahasuese, si dhe metodat tjera direkte dhe indirekte që lidhen me llogaritjen e detyrimit tatimor. Metodatat indirekte mund të përdoren edhe në rastet kur nuk janë dorëzuar deklaratat, si dhe në rastet në të cilat ka dyshim se nuk ka saktësi të detyrimit tatimor të deklaruar.
  5. Në qoftë se regjistrat e një personi të vetë-punësuar kanë humbur apo janë shkatërruar ose ekzistojnë rrethana tjera që bëjnë të pamundur përcaktimin e shumës së kontributeve për pension dhe kontributeve tjera sipas legjislacionit në fuqi, ATK bën një vlerësim të kontributeve për pension dhe kontributeve tjera të barabartë me nivelin e detyrimit të kontributeve për periudhën e mëparshme mujore ose tremujore.
  6. Vlerësimi për tatimet e mbajtura në burim bëhet në të njëjtën mënyrë dhe i nënshtrohet dispozitave dhe kufizimeve të njëjta që janë të zbatueshme për tatimet të cilat nuk janë mbajtur në burim.
  7. Tatimpaguesi ka barrën e provës për të vërtetuar se ndonjë vlerësim i kryer nga ATK është i gabuar.[...].”
24. Lidhur me këtë çështje Avokati i Popullit thekson se dispozitat e theksuar më sipër të Ligjit të kontestuar nuk paraqesin qartë një qëllim legjitim, përmes të cilit do të arsyetohej veprimtaria e institucioneve financiare dhe noterëve në drejtim të dhënies së informatave të caktuara ATK-së. Si rezultat i kësaj paqartësie, Avokati i Popullit konsideron se veprimet e tilla mund të bien ndesh me nenin 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës.
  25. Avokati i Popullit vëren se Direktiva e Këshillit 2014/107/BE, e datës 9 dhjetor 2014, që ndryshon Direktivën 2011/16/BE, në lidhje me shkëmbimin automatik të detyrueshëm të informacionit në fushën e taksave<sup>1</sup>, flet për balancën dhe jo për transaksionet. Ndërsa Rregulloja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (General Data Protection Regulation)<sup>2</sup>, për sa i përket së drejtës së privatësisë, i përcakton 7 parime dhe ato janë: Ligjshmëria, drejtësia dhe transparenca; Qëllimi i kufizimit; Minimizimi i të dhënave; Saktësia; Kufizimi i ruajtjes; Integriteti dhe konfidencialiteti, si dhe Llogaridhënia.
  26. Avokati i Popullit konsideron se në rastin konkret, me përcaktimin e nenit 9 [Mbledhja e informatave ose provave], paragrafët 5, 6 dhe 7, të Ligjit të kontestuar, në kuptim të ligjshmërisë dhe të qëllimit legjitim nuk vihet mjaftueshëm në dukje nëse kërkesa për transaksionet është proporcionale për qëllimin që synohet t'i shërbejë. Pra, kërkesa e ATK-së për qasje në transaksione ndaj të gjithë personave juridikë dhe fizikë, në parim duket se ka qëllim legjitim, por duhet të ekzistojë një dyshim i bazuar për shmangie apo keqpërdorim për një kërkesë të tillë, dhe kjo mund të arsyetohet për raste të caktuara individuale, por jo të kërkohen transaksionet “përse”.

<sup>1</sup>Council Directive 2014/107/EU of 9 December 2014 amending Directive 2011/16/EU as regards mandatory automatic exchange of information in the field of taxation Shih në: <https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2014/107/oj>

<sup>2</sup>GDPR-ja mbulon gjithashtu transferimin e të dhënave personale në vendet joanëtare të BE-së dhe në organizatat ndërkombëtare. Komisioni Evropian është përgjegjës për vlerësimin e nivelit të mbrojtjes së dhënë nga një territor ose sektor përpunues në një vend jashtë BE-së. Kur Komisioni nuk ka marrë një vendim për përshtatshmërinë për një territor ose sektor, transferimi i të dhënave personale mund të bëhet ende në raste të veçanta ose kur ekzistojnë masat e duhura mbrojtëse.

27. Në bazë të GDPR-së, kërkohet që të mblidhet vetëm sasia minimale e të dhënave personale të nevojshme për qëllimin specifik dhe nëse detajet e transaksionit janë më shumë sesa është e nevojshme për qëllimin e ATK-së, mund të argumentohet se kjo cenon parimin e minimizimit të të dhënave. Për më tepër, subjekti i të dhënave (tatimpaguesi) duhet të informohet se çfarë të dhënash mblidhen, për çfarë qëllimi dhe si do të përdoren. Nëse tatimpaguesi është informuar siç duhet dhe ka dhënë pëlqimin aty ku kërkohet, kërkesa nuk mund të përbëjë shkelje. Mënyra në të cilën të dhënat kërkohen, transmetohen dhe ruhen duhet të garantojë sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave. Çdo dështim në sigurimin e duhur të të dhënave mund të çojë në shkelje.
28. Në rastin Gillan dhe Quinton kundër Mbretërisë së Bashkuar (Aplikimi nr.4158/05), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) trajtoi çështjen e balancës ndërmjet interesave shtetërore dhe të të drejtave individuale të privatësisë, megjithëse kjo çështje fokusohet më shumë në kompetencat e ndalimit dhe kërkimit sipas legjislacionit kundër terrorizmit, ofron një pasqyrë se si GjEDNj-ja i balancon këto të drejta. Në çështjen në fjalë, Gjykata rikujton se formulimi “në përputhje me ligjin” kërkon që masa e kundërshtuar të ketë disa baza në ligjin e brendshëm dhe të jetë në përputhje me shtetin e së drejtës, i cili është përmendur shprehimisht në preambulën e Konventës dhe e përfshirë në objektin dhe qëllimin e nenit 8 të KEDNj-së. Ligji duhet të jetë në mënyrë adekuate lehtësisht i qasshëm dhe i parashikueshëm, pra, i formuluar me saktësi të mjaftueshme për t’i mundësuar personit - nëse do të jetë e nevojshme me këshillimin e duhur - të rregullojë sjelljen e tij (Aktgjykimi nr.4158/05, paragrafi 76).
29. Më tutje në paragrafin 77 të Aktgjykimit nr.4158/05 të GjEDNj-së, gjykata thekson: “*Që ligji e brendshëm t’i përmbushë këto kërkesa duhet të sigurojë masa mbrojtjeje ligjore kundër ndërhyrjeve arbitrare nga autoritetet publike në të drejtat e garantuara nga Konventa. Në çështjet që ndikojnë në të drejtat themelore do të ishte në kundërshtim me parimin e shtetit të së drejtës, si një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike, e mishëruar edhe në Konventë, që një diskrecion ligjor që i është dhënë ekzekutivit të jetë i shprehur në kushtet e një kompetence të pakufizuar. Rrjedhimisht, ligji duhet të tregojë me qartësi të mjaftueshme shtrirjen e këtij diskrecioni të dhënë autoriteteve kompetente dhe mënyrën e ushtrimit të tij (Rotaru kundër Rumanisë [GC], nr.28341/95, § 55, ECHR 2000-V; Hasan dhe Chaush kundër Bullgarisë [GC], nr.30985/96, § 4, ECHR 2000-XI; Maestri kundër Italisë [GC], nr.39748/98, § 30, ECHR 2004-I; shih gjithashtu, në ndërmjet shembuj të tjerë, Silver dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, 25 mars 1983, §§ 88-90, Seria A nr. 61; Funke kundër Francës, §§ 56-57, vendimi i 25 shkurt 1993, Seria A nr. 256-A, Al-Nashif kundër Bullgarisë, nr.50963/99, § 119, 20 qershor 2002; Ramazanov dhe të Tjerët kundër Azerbajxhani, nr.44363/02, § 62, 1 shkurt 2007; Glas Nadezhda EOOD dhe Anatoliy Elenkov kundër Bullgarisë, nr.14134/02, § 46, ECHR 2007-XI (ekstrakte); Vlasov kundër Ruisë, nr.78146/01, § 125, 12 qershor 2008; Meltex Ltd dhe Movsesyan kundër Armenisë, nr.32283/04, § 81, 17 qershor 2008).”*
30. Niveli i duhur i qartësisë së legjislacionit të brendshëm, i cili në asnjë rast nuk mund të parashikojë çdo eventualitet, varet në masë të madhe nga përmbajtja e instrumentit në fjalë, nga fusha që ai synon të rregullojë dhe nga numri dhe statusi i atyre të cilëve u drejtohet (shih, për shembull, Hashman dhe Harrup k. Mbretërisë së Bashkuar [GC], no.25594/94, § 31, ECHR 1999-VIII; S. dhe Marper, cituar më lart, § 96). Sipas mendimit të gjykatës, ekziston rrezik i qartë për arbitraritet në dhënien e gjerë të

diskrecionit autoriteteve përkatëse. Në rastin në fjalë, gjykata kishte vlerësuar, ndër të tjerash, shkelje të nenit 8 të KEDNj-së.

31. Më tej Avokati i Popullit, duke iu referuar praktikës së GjEDNj-së, ka vërejtur se në rastin M.N. dhe të tjerët kundër San Marinos, GjEDNj-ja konsideronte se të dhënat bankare përbënin të dhëna personale të subjekteve, pavarësisht se a është informacion i ndjeshëm (sensitiv) apo jo (shih rasti M.N. dhe të tjerët kundër San Marino, app. no. 28005/12, §51).
32. Avokati i Popullit vë në dukje çështjen e proporcionalitetit për sa u përket përcaktimeve të dhëna me nenin 9 të Ligjit të kontestuar dhe thekson se ruajtja e privatësisë së personave fizikë dhe juridikë është në disproporcion me qëllimin dhe parandalimin e krimit. Në këtë drejtim Avokati i Popullit thekson se ligji duhet të ketë parasysh balancimin e interesave shtetërore dhe të të drejtave individuale të privatësisë. Pra, përcaktimet ligjore me rastin e rregullimit të çështjeve të kërkesave për transaksione, në kuptim të nenit 8 të KEDNj-së, duhet të jenë në pajtim me parimin e ligjshmërisë, të domosdoshmërisë, të proporcionalitetit dhe të masave mbrojtëse të përshtatshme.
33. Përveç kësaj, Avokati i Popullit, duke iu referuar praktikës së GjEDNj-së, thekson se për sa u përket procedurave të tatimeve, GjEDNj-ja mban qëndrim se ato si të tilla, në parim paraqesin një ndërhyrje në të drejtën e garantuar nga paragrafi 1 i Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNj-së, meqenëse tatimi e privon personin në fjalë nga një posedim, përkatësisht shumën e parave që duhet paguar (*Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], § 59; Špaček, s.r.o., kundër Republika Çeke, § 39; Bežanić dhe Baskarad kundër Kroacia, § 60*).
34. Megjithatë, një detyrim financiar që lind nga mbledhja e tatimeve mund të ndikojë negativisht në garancinë e pronësisë nëse vendos një barrë të tepërt për personin në fjalë ose ndërhyrje rrënjësisht në gjendjen e tij financiare (*Ferretti kundër Italisë, vendimi i Komisionit; Wasa Liv Ömsesidigt, Försäkringsbolaget Valands Pensionsstiftelse dhe një grup prej rreth 15,000 individësh v. Suedi, Vendimi i Komisionit; Buffalo S.r.l. në likuidim v. Itali § 32*).
35. Me këtë rast, edhe pse Avokati i Popullit nuk lëshohet në “barrën financiare” direkte, megjithatë konsideron se procedurat e tilla vënë një barrë joproporcionale në raport me subjektet ekonomike, e cila më pas mund të rezultojë në barrë financiare dhe praktike.
36. Prandaj Avokati i Popullit thekson se obligimet e tilla, të përcaktuara në Ligjin e kontestuar, kanë ndikim negativ edhe në të drejtën e pronës, sepse procedurat e tilla vënë një barrë joproporcionale dhe mund të rezultojnë me barrë financiare për subjektet ekonomike.
37. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh përcaktimet në dispozitat e theksuara më sipër të Ligjit të kontestuar, konsideron se obligimi i institucioneve financiare që t'i dorëzojnë në ATK informatat për të gjitha transaksionet vendore dhe ndërkombëtare, e po ashtu obligimi i noterëve që t'i dorëzojnë në ATK informatat për të gjitha kontratat e shitblerjeve nga personat juridikë, nga personat fizikë afaristë dhe nga personat fizikë joafaristë, pa një qëllim legjitim të caktuar, bien në kundërshtim me nenin 36 [E Drejt e Privatësisë] të Kushtetutës.

## **Për sa i përket së drejtës së pronës, sipas nenit 46 të Kushtetutës**

38. Avokati i Popullit ka vërejtur se Ligji i kontestuar në nenin 79 [Emërimi dhe mandati i pozitave drejtuese] përcakton:

*“1. Pozitat drejtuese në ATK ndahen dhe përfshijnë dispozitat si në vijim:*

*1.1. Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së;*

*1.2. Zv. Drejtorët e Përgjithshëm;*

*1.3. Drejtorët e Departamenteve Qendrore;*

*1.4. Drejtorët e Departamenteve Rajonale.*

[...]

*4. Përfundimisht Drejtorit të Përgjithshëm mandati i të cilit është i përcaktuar se kur përfundon, të gjitha pozitat të tjera drejtuese sipas paragrafëve 1.2, 1.3 dhe 1.4 u përfundon mandati një (1) vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Në rast të sistemimit në një pozitë më të ulët në ATK sipas dispozitave të këtij ligji, ky staf vazhdon të merr vlerën e njëjtë të pagës (vlerë të njëjtë monetare) gjatë marrëdhënies së punës në ATK nëse pozita e mbajtur ka pagë më të ulët (vlerë më të ulët monetare) sesa vlera e pagës sipas këtij paragrafi.”*

39. Lidhur me këtë përcaktim në Ligjin e kontestuar (neni 79, paragrafi 4), Avokati i Popullit konsideron se as Qeveria e Republikës së Kosovës dhe as Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk i kanë marrë parasysh gjetjet dhe konstatimet e Gjykatës Kushtetuese të shprehura në Aktgjykimin KO 216/22 dhe KO 220/22, me të cilin është vlerësuar përputhshmëria me Kushtetutën e Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

40. Përkitazi me këtë çështje, Avokati i Popullit ka vërejtur se Gjykata Kushtetuese, në Aktgjykimin për rastet KO 216/22 dhe KO 220/22, në paragrafin 323 ka theksuar:

*“Gjykata thekson që përmes nenit 46 afektohen zyrtarët publikë që emërohen/përzgjedhen në pozita të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar. Në një rrethanë të tillë, neni 46 i Ligjit të kontestuar nuk afekton të drejtat e fituara të zyrtarëve publikë që aktualisht mbajnë pozita të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues në administratën publike. Çdo pozitë e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues që fitohet pas hyrjes së Ligjit të kontestuar në fuqi, do të bëhet përmes dispozitave të Ligjit të ri, përkatësisht Ligjit të kontestuar, dhe nëpunësit përkatës civilë do të kenë paraprakisht të qarta të drejtat dhe detyrimet përkatëse. Gjykata sqaron që të drejtat dhe detyrimet e nëpunësve publikë/civilë të fituara bazuar në ligjin e aplikueshëm për shërbimin civil dhe/ose zyrtarët publikë, do të trajtohen ndaras në këtë Aktgjykim në kontekst të vlerësimit të kushtetutshmërisë së nenit 99 të Ligjit të kontestuar.”*

41. Sipas paragrafit të theksuar më sipër, Avokati i Popullit vlerëson se Gjykata Kushtetuese qartë ka theksuar se neni 46 [Emërimi dhe mandati në pozitat e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues] i Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë nuk vlen për, ose thënë ndryshe, nuk i afekton të drejtat e zyrtarëve publikë, të drejta këto që janë fituar para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Sipas këtij përcaktimi vërehet se ky rregullim vlen vetëm për pozitat që krijohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji (Ligji për Zyrtarët Publikë), e që në rastin konkret, paragrafi 4 i nenit 79 të Ligjit të kontestuar duhet të vlejë vetëm për pozitat

që themelohen pas hyrjes në fuqi të ligjit, por jo edhe për pozitat që janë themeluar para hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar.

42. Avokati i Popullit ka vërejtur se paragrafi 4 i nenit 79 të Ligjit të kontestuar është i ngjashëm me paragrafin 2 të nenit 99 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, paragrafi ky i shfuqizuar me Aktgjykimin KO 216/22 dhe KO 22/22, për shkak të konstatimit se paragrafi në fjalë nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [E Drejta e Pronës] të Kushtetutës.
43. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh konstatimet e Gjykatës Kushtetuese, të shprehura në Aktgjykimin KO 216/22 dhe KO 220/22, konsideron se Qeveria dhe Kuvendi është dashur t'i merrnin parasysh konstatimet Gjykatës Kushtetuese lidhur me çështjen e theksuar më sipër.
44. Prandaj për këtë çështje Avokati i Popullit konsideron se përcaktimet në paragrafin 4 të nenit 79 të Ligjit të kontestuar mund të mos jenë në pajtim me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe e konsideron të rëndësishme që Gjykata Kushtetuese ta vlerësojë këtë çështje, nëse dispozita e theksuar më sipër është në përputhshmëri me nenin 46, paragrafët 1 dhe 2.

## V. KËRKESË PËR MASË TË PËRKOHSHME

Në bazë të argumenteve të lartcekura, Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, me anë të kësaj parashtrëse, kërkon që kjo Gjykatë të vendosë masë të përkohshme për pezullimin e menjëhershëm të nenit 26, paragrafi 3, dhe të nenit 79, paragrafi 4, të Ligjit të kontestuar.

Avokati i Popullit, duke pasur parasysh se Rregullorja e Punës e Gjykatës Kushtetuese, Rregulli 55, paragrafi 4, përcakton tri kushte që duhet të përmbushen në mënyrë që masa e përkohshme të rekomandohet:

*“(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;*

*(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësohen dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe*

*(c) masa e përkohshme është me interes publik.”*

Në rastin konkret janë përmbushur të tria këto kushte.

Së pari, Avokati i Popullit konsideron se argumentet e parashtruara në këtë kërkesë japin bazë më shumë se *prima facie* për shfuqizimin e dispozitave të kontestuara, duke pasur parasysh faktin se te neni 26, paragrafi 3, pas kalimit të afatit 3-vjeçar, tatimpaguesit i humb mundësia dhe e drejta që të kërkojë rimbursimin për pagesat e tepërta, ndërsa lidhur me nenin 79, paragrafi 4, përveç argumenteve të paraqitura nga Avokati i Popullit, për çështje krejtësisht të ngjashme edhe Gjykata Kushtetuese ka vendosur me Aktgjykimin KO 216/22 dhe KO 220/22.

Së dyti, në mungesën e miratimit të masës së përkohshme, mund të realizohen ndryshime sipas përcaktimeve të nenit 26, paragrafi 3, dhe të nenit 79, paragrafi 4, të Ligjit të kontestuar, përkatësisht mund të humbë e drejta e kërkesës për rimbursimin, për shkak të pagesave të

tepërta (neni 26, paragrafi 3), si dhe mund të fillojnë procedurat e rekrutimit (neni 79, paragrafi 4), dhe si pasojë e atyre procedurave të shkaktohen pasoja të pariparueshme të të drejtave të njeriut.

Avokati i Popullit konsideron se për Ligjin e kontestuar është interes publik që sundimi i ligjit të jetë funksional dhe efikas deri në nxjerrjen e një qëndrimi nga Gjykata Kushtetuese lidhur me dispozitat e kontestuara.

## VI. PËRFUNDIMI

Duke i marrë parasysh çështjet e ngritura në pjesën e Argumentit, Avokati i Popullit kërkon nga Gjykata Kushtetuese ta vlerësojë:

- Nëse neni 14 [Vetëvlerësimi], neni 16 [Kufizimet kohore për vlerësimet] dhe neni 26 [Kreditimet dhe rimbursimet] janë në përputhshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.
- Nëse neni 9 [Mbledhja e informatave ose provave], paragrafët 5, 6 dhe 7, është në përputhje me nenin 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës.
- Nëse neni 79, paragrafi 4, i Ligjit të kontestuar ka marrë parasysh gjetjet e Gjykatës Kushtetuese, të shprehur nëpërmjet Aktgjykimit në rastet nr. KO 216/22 dhe KO 220/22, për sa u përket emërimit dhe mandatit të pozitive drejtuese në Administratën Tatimore të Kosovë, si dhe nëse është në përputhshmëri me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës].
- Nëse neni 89, paragrafi 12, i Ligjit të kontestuar është në përputhshmëri me nenin 32 [Mjetet Juridike], me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe me nenin 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës.

Naim Qelaj  
Avokat i Popullit